

DRAFTI I
RAPORTIT TE VLERESIMIT TE NDIKIMIT
NE MJEDIS
TE AKTIVITETIT:
“Impiant prodhimi e fraksionimi i inerteve”

Subjekti: “ANK” sh.p.k





Vendndodhja: Floq, Korce

Pergatiti materialin : “Eko- Studio- Projekt” sh.p.k

Tirane, 2013



PERMBAJTJA

-  Hyrje
-  Baza ligjore
-  Metodika e vleresimit te mjedisit
-  Objektivat dhe qellimi i VNM-se

1. **PERSHKRIMI I AKTIVITETIT**
2. **PERSHKRIMI I RAJONIT KU DO ZHVILLOHET AKTIVITETI**
3. **VLERESIMI I NDIKIMEVE NEGATIVE NE MJEDIS**
4. **MASAT PER ELEMENIMIN/ZVOGELIMIN E NDIKIMEVE**
5. **KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME**

HYRJE

Aktiviteti njerezor qe zhvillohet ne çdo aspekt te vetin, perveç dobesive ne menyre te pashmangshme krijon dhe “produkte” qe ne perfundim mund te sjellin probleme per zhvillimin e qendrueshem te mjedisit. Pavaresisht nga vlerat dhe volumet edhe ne Shqiperi keto probleme vrojtohen dhe shoqeria e shteti kane synuar dhe vazhdojne te organizojne dhe orientojne kete proces. Ndotja e mjedisit nenkupton shkarkimet e cdo lloj mbetje nga pjese te materialeve te ndryshme ne uje , toke, ajer e cila shkakton ose mund te shkaktoje probleme mjedisore te perkoheshme ose te perhershme ne balancen ekologjike te tokes. Se bashku me zhvillimin e madh qe eshte bere ne industri te ndryshme ne menyre te ngjashme me te njejten shpejtesi eshte rritur edhe sasia e mbetjeve nga perdorimi i te mirave materiale. Mbetjet industriale dhe ato urbane te patrajuara , emetimet e gazeve te demshem ne atmosfere , perdorimi i kimikateve te reja pa marre parasysh demet qe mund ti sjellin mjedisit kane sjelle problemet mjedisore me te cilat ne perballemi ne ditet e sotme.

Ndaj eshte e nevojshme qe shoqeria te ndergjegjesohet per ta mbajtur sa me paster mjedisin ku jetojme duke marre masat e duhura per trajtimin e mbetjeve si dhe emetimin e gazeve te demshem ne atmosfere qe gjenerohen nga zhvillimi i aktiviteteve te ndryshme.

Materiali qe paraqitet trajton ndikimet ne mjedisin fizik dhe human te aktivitetit:

“Impiant fraksionimi inertesh”

BAZA LIGJORE

Relacioni u pergatit ne zbatim te akteve ligjore dhe nenligjore Mjedisore :

- *Ligji Nr.10 431, date 09.06.2011 “ Per Mbrojtjen e Mjedisit”*
- *Ligji nr. 10 448 date 14.07.2011 « Per Lejet e Mjedisit »*
- *Ligji nr.10 440 date 07.07.2011 « Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis »*
- *Urdhrin e ministrit nr. 146 dt. 8.5.2007 ”Per miratimin e listes se kuqe te flores dhe faunes”*
- *Udhezimin nr 8 dt. 27.11.2007 “Per nivelin kufi te zhurmave ne mjedise te caktuara”*
- *Ligji nr. 9010 dt. 13.02.2003 “Per administrimin mjedisor te mbetjeve te ngurta”*
- *Ligji nr. 8897 dt. 16.05.2002 “Per mbrojtjen e ajrit nga ndotja”*
- *Ligji nr. 10 463 date 22.09.2011 “Per menaxhimin e integruar te mbetjeve”*
- *Vendim nr.805 date 4.12.2003 « Per miratimin e listes se veprimtarive qe ndikojne ne mjedis per te cilat kerkohet leje mjedisore »*

- Ligj nr. 8094 date 21.03.1996 « Per largimin publik te mbeturinave »
- Udhezim nr.1 date 03.03.2009 « Per detyrat e organeve mjedisore per te siguruar pjesemarrjen e publikut dhe te OJF-ve mjedisore ne procesin e vleresimit te ndikimit ne mjedis »
- Udhezim nr.3 date 19.11.2009 'Per metodologjine e raportit te VNM'
- VKM nr.419 date 25.6.2014 « Per miratimin e kerkesave te posacme per shqyrtimin e kerkesave per leje mjedisi te tipave A,B dhe C per transferimin e lejeve nga nje subjekt te tjetri, te kushteve per lejet respektive te mejdisit si dhe rregullave te hollesishme per shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri ne leshimin e ketyre lejeve nga QKL-ja ».
- Vendim Nr.13, date 04.01.2013 ” Per miratimin e rregullave, te pergjegjesive e te afateve per zhvillimin e procedures se Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis”.

1. PERSHKRIMI I AKTIVITETIT

➤ **Profili i propozuesit**

Subjekti ”ANK”sh.p.k eshte rregjistruar prane QKR me numer NIPT-ti **J92408001N** . Vendi i ushtrimit te aktivitetit eshte ne **Floq,Korce**.

IMPIANTI I FRAKSIONIMIT TE GURIT GELOEROR

Aktiviteti ndodhet ne fshatin Floq,Korce.Siperfaqja totale e sheshit ku ushtrohet aktiviteti i fraksionimit te gurit gelqeror eshte 1000m² ,ne kete hapesine 25% te sheshit e zene makinerite.Gjithashtu jane edhe 2 godina ku siperfaqja e tyre eshte afersisht te 50m² ,godina e pare sherben per komandimin e makinerive dhe ka nje siperfaqje rreth 20m² ,kurse godina e dyte sherben per ambiente zyre e cila ka nje siperfaqje 30m² ,te gjitha keto hapesira garantojne levisjen dhe qarkullimin e lire te mjeteve dhe njerezve qe i sherbejne ketij aktiviteti. Objekti eshte i rrethuar nga te gjitha anet e tij me hapesira te konsiderueshme duke bere qe hyrjet ,daljet dhe manovrimet e makinave te jene te garantuara dhe ne kushte te plota sigurie.

➤ **Sheshi per depozitim te lendes se pare**

Ne kete shesh behet depozitimi i gurit gelqeror te siguruar nga karriera.Ngarkimi i gelqeroreve dhe transportimi i tyre do te behet direkt me mjetet perkatese.Ngarkimi do te behet me eskavatore me zinxhira me kapacitet kove 2m³ ,ndersa transporti me automjete me goma vetshkarkuese,dambera me kapacitet transportues 16m³.

➤ **Procesi teknologjik i impiantit te fraksionimit**

Procesi teknologjik ne impiantin e thyerjes se gurit dhe fraksionimt te objektit te Floq,te subjektit ‘ANK’ sh.p.k konsiston ne marrjen e gurit gelqeror nga karriera qe ndodhet aty afer,transportimin e tyre tek impianti i thyerjes dhe fraksionimit,thyerjen dhe fraksionimit sipas kerkesave teknike per perdorimin e tyre ne industrine e ndertimit. Qellimi i ngritjes se ketij impianti eshte shfrytezimi dhe rritja e efektivitetit te perdorimit te gurit gelqeror te karrieres me qellim perdorimin e tyre ne sektorin e ndertimit.

Procesi teknologjik ne impiantin e thyerjes dhe fraksionimit te gurit gelqeror realizohet permes makinerive te pershkruara ne skeme dhe qe perbehet nga :

1. Bunkieri per gurin gelqeror
2. Transportieret
3. Mulliri
4. Sitat e medha dhe te vogla
5. Pedane per shperndarje te materialit dhe transportieri

Makinerite jane prodhim i vitit 2002,kane ardhur nga Italia dhe mund te themi se jane nder impiantet e pare qe kane hyre ne vendin tone ne ato vite,jane te certifikuara dhe kane standarte te cilat i kerkon Bashkimi Evropian per mbrojtjen e mjedisit. Procesi i thyerjes dhe i fraksionimit kryhet gjithmone ne pranine e ujit.Ky uje duhet te riciklohet per tu perdorur nqs eshte e nevojshme ose ka krize uje.Pastaj pas riciklimit ujrat kalojne ne dampe ku behet dekantimi,aty ngel llumi kurse uji kalon nepermjet nje kanali dhe me pas mund te perdoret per nevojat e subjektit per ujitjen e pemeve ose luleve.

Materiali i marre ne ne karriren e gelqeroreve ,me ane te kamioneve riportabel te firmes,nga zona e shfrytezimit transportohet dhe depozitohet prane impiantit te thyerjes dhe fraksionimit.Prej nga aty hidhet ne bunker dhe i nenshtrohet procesit qe thame me siper.Impianti i fraksionimit eshte i vendosur mbi nje bazament betoni,mase kjo e marre per te siguruar mjetet e transportit,me pas eshte mulliri i cili ben thyerjen e materialit ne dimensione mbi 40mm dhe larjen e tij nga papastertite ,me anen e sitave pas thyerjes behet fraksionimi i materialit ne rere me dimensione 0-4 mm,granil ne 4-10 mm dhe ne 10-30 mm,pastaj stabilizante 0-40 dhe makadam 0-50.

Procesi i perpunimit te gurit gelqeror konsiston ne marrjen e gurit nga karriera qe ndodhet aty afer vazhdon me transportimin e tij per tek makinerite,pastaj me thyerjen dhe fraksionimin sipas kerkesave teknike, per perdorimin e ketij materiali ne dimensione te ndryshme ashtu sic e kerkon industria e ndertimit.

Infrastruktura e nevojshme, rrjeti elektrik, furnizimi me uje, shkarkimet e ujerave te ndotura dhe mbetjeve, rruget ekzistuese).

- ***Lenda djegese***

Proçesi nuk perdor lende djegese. Vetem perdorin mjetet e ngarkim-shkarkimit sipas normativave dhe kohes se punes, e cila eshte 6 dite ne jave vetem me nje turn.

- ***Furnizimi me uje***

Ne teknologjine e prodhimit te gurit gelqeror me karriere nuk perdoret uji. Uji do te perdoret ne periudhe te thate per lagien e rrugeve te levizjes se mjeteve te transportit, lagien e ngarkesave te gurit gelqeror ne mjetet e teransportit, ne impiantin e thyerje fraksionimit dhe per sherbime

vetiake nga personeli sherbimit ne karriere. Sasi e ujit do te jete minimale. Uje do te sigurohet me depozite qe do te furnizohet me autobot qe ka ne perdorim subjekti.

- ***Furnizimi me energji elektrike***

Firma private “ANK” sh.p.k. e siguron energjinë elektrike nëpërmejt dy rrugëve të pavarura nga njëra tjetra. Furnizimi kryesor kryhet nga rrjeti ndersa për të krijuar pavaresi nga problemet energjitike ajo ka instaluar një motorr me djegie të brëndëshme të cilin e vë në punë sipas nevojës.

- ***Skema e tokezimit dhe e mbrojtjes nga shkarkimet atmosferike***

Skema perbehet nga disa elektroda te zhytyra ne toke ne thellesine 1-2 m dhe te lidhura me nejra-tjetren me nje shirit metalik,i cili eshet i lidhur me impiantin,mullirin,sitat dhe te gjitha pjeset metalike me qellim mbrojtjen nga shkarkimet atmosferike dhe nga ngarkesat elektostatike qe te mund te krijohen ne makinerite gjate procesit te punes ashtu dhe kur nuk jane ne pune qe te jene te garantuara makinerite dhe punonjesit kur jane duke punuar ne kushtet kur ka shkarkime atmosferike.Ne projekte eshte parashikuar tokezimi i makinerive dhe i trupave te elektomotoreve. Rezistenca e matur duhet te jete 4-10 Ω .

- ***Instalimi I fuqise motorike dhe I ndricimit***

Linja e jashtme e furnizimit eshte kabllore dhe eshte e vendosur direkte ne objekt ku ndodhet edhe transformatori me fuqi 450kV nga aty per te impianti.Te gjitha makinerite kane nje projekt te vecante elektirk ne te cilen perfshihen instalimet elektrike me linje kabllore dhe siguresa te vecanta per cdo makineri.Mbi bazen e instalimave elektrike sipas skemes te paraqitur ne planimetri arrihet furnizimi me energji elektrike dhe njekohesisht shkeputja automatike e siguresa,ne raste difekti.

- ***Masat kunder zjarrit***

Me qellim per te siguruar nje nderhyrje te shpejte ne raste zjarri, do te vendoset nje sistem I perbere nga hidrante. Perverc kesaj subjekti ka vendosur edhe fikse me shkume, gjithashtu ka dhe mjetet e nevojshme per punetoret si kazem, lopate dhe 2 fuci me rere per raste kur mund te bjere zjarr. Gjithashtu dhe personeli eshte instruktuar paraprakisht per masat parandaluese kunder zjarrit, me mjetet te cilat jane cituar me lart.

2. PERSHKRIMI I RAJONIT KU DO ZHVILLOHET AKTIVITETI

Pozita gjeografike

Qyteti i Korçës shtrihet ne pjesën juglindore te Shqipërisë dhe është qendra e banuar më e madhe e pellgut me të njëjtin emër. Pellgu i Korçës ka një lartësi mesatare prej 850m mbi nivelin e detit, me gjërësi 16 km nga perëndimi në lindje dhe me gjatësi 35 km nga jugu

në veri, dhe zë një sipërfaqe prej 300km². Korça ka një pozite të favorshme gjeografike pasi ndodhet në rrugët tregëtare që lidhin Shqipërinë me Maqedoninë (47km) dhe Greqinë(35km). Fusha e Korces është një nder fushat më të mëdha në Shqipëri. Malet zënë 58% të sipërfaqes, kodrat 17% dhe fushat 25%.

Cilesia e ajrit,temperature,reshjet atmosferike.....

Korça ka [klime mesdhetare](#) kalimtare (ose [klime mesdhetare kontinentale](#)) me ndryshime të mëdha në temperaturë. Muaji më i nxehtë është [gushti](#) (25°C) ndërsa muaji më i ftohtë është [janari](#) (8°C). Mesatarisht gjatë vitit bien 700 mm reshje të cilat minimumin e arrijnë në verë ndërsa maksimumin në dimër, duke e bërë Korcen një qytet përgjithësisht të thatë krahasuar me pjesën tjetër të [Shqipërisë](#) së lagësht. Temperaturat në Korçe që përthith 2000 orë rrezatimin diellor, përgjithësisht mbeten më të ulta se pjesa tjetër e [Shqipërisë perëndimore](#), por më të larta se pjesa veri-perëndimore për shkak të lartësisë mesatare në rrafshin e Bilishtit.

Korçe - Temperatura dhe reshjet mesatare mujore

	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrikk	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	
Temp. Maks. (°C)	4	7	8	14	19	24	28	29	22	17	10	6	Ø 15,7
Temp. Mini. (°C)	-3	-2	-1	4	9	12	14	15	11	7	3	-1	Ø 5,7
Reshje (mm)	58	89	51	53	99	25	18	10	51	81	132	53	Σ 720

Flora dhe fauna

Dominojnë drurë si bredhi i Maqedonisë (*Abies borisi Regis*), që ndodhet i kufizuar në Shqipërinë Juglindore, pisha e zezë, panja dhe tisi (*Taxus bacata*) që është tepër i rrallë. Këtu rritet numri më i madh i gjitarëve në Shqipëri. Ka vlera të pakrahasueshme për

zhvillimin e ekoturizmit, sporteve dimërore, alpinizmit dhe ekskursioneve. Zona e Prespës është shpallur me vendim qeverie si zonë turistike dhe Park Kombëtar, ku natyra ka dhuruar dhe harmonizuar pyllin dhe liqenin të cilat krijojnë mundësi zhvillimi për një turizëm rural gjithëvjetor.

Burimet ujore

Rajoni i Korces laget nga liqene, lumenj dhe perrenj te ndryshem:

- Liqeni i Ohrit
- Liqenet e Prespes se madhe dhe te vogel
- Lumi i Devollit
- Lumi i Dunavecit

Rezervat ujore te ketij rajoni perbehen prej dy burimesh furnizimi:

1. Furnizimi nepermjet shtresave ujembajtese nentokesore te cilat aktualisht sot perdoren per uje te pijshem dhe ne prespektive mund te perdoren per ujitjen e zonave.
2. Furnizimin nepermjet ujrave siperfaqesore qe dalin nepermjet burimeve malore apo fushore. Pjesa me e madhe e ketyre burimeve perdoren per uje te pijshem me rrjedhje te lire ose ngritje mekanike. Me baze nga keto burime jane dhe rrjedhat e lumenjve te Devollit-Osumit-Dunavecit-Tushemishtit e perrenj te tjere.

- **Burimet nentokesore**

Zona e Korces eshte e pasur me burime nentokesore te tipit metalor dhe jo metalor

- Metalore: baker, hekur nikel, krom, dhe nikel silikat
- Jo metalore: gur talku, asbest, rere kuarcore.
- Jo metalore energjitike: qymyrguri
- Jo metalore (materile ndertimi dekorative) argjila per tulle, gure gerqeror per ndertim, guri i kuq i Polenes, guri i shtufit, zhavore, rera per beton etj.

3. VLERESIMI I NDIKIMEVE NEGATIVE NE MJEDIS

Çdo aktivitet qe zhvillohet shoqerohet me pasoja dhe ndikime ne mjedis, qe jane pjese e atij kompromisi qe shoqeria jone ka zgjedhur per tu zhvilluar. Megjithate e rendesishme eshte qe te

kuptohet natyra e ketyre proceseve, forma e shfaqjes se tyre dhe me analitikiisht ndikimet e cdo operacioni te kryer.

- **Ndikimet ne toke**

Mbetjet teknologjike jane fraksione te imeta nga linja e fraksionimit te inerteve (mase e imet) qe varion 1- 1.5 % e sasise se lendes se pare te perpunuar. Kjo mase eshte ne sasi teper te vogel sistemohet dhe riperdoret nga zona. Mbetje me fraksion mbi 20 mm e linjes se fraksionimit, e cila perdoret per mbushje dhe rilevime te territorit. Kjo sasi mbetje eshte 5-10 % te sasise se lendes se pare te perdorur.

- **Ndikimet mbi popullsine**

Zhvillimi i ketij aktiviteti nuk ka ndikime negative mbi popullsine perreth,pervecse zhvillimi i ketij aktiviteti do te sjelle punesimin e disa baroreve perreth duke kontribuar sadopak ne rritjen e mireqenies ne zone perreth.

- **Ndikimet ne cilesine e ajrit**

Persa i perket shkarkimeve ne ajer nga zhvillimi i aktivitetit nuk emetohen gaze te demshem ne atmosfere per mjedisin apo banoret e zones perreth. Referuar natyres se procesit nuk kemi sasi gazesh te shkarkuar ne atmosfere, por vetem pluhur . Per te minimizuar kete ndikim negativ eshte bere nje izolim ne pjesen e daljes se mases se fraksionuar per ne transportier, me nje skelet dhe dok te gomuar ne menyre qe pluhurat te mos perhapen ne menyre kaotike, sidomos ne kohe te thate dhe me erë.

- **Ndikimet ne uje**

Jane ujerat teknologjike nga larja e lendes se pare, gurit gelqeror, te cilat dekantohen ne grope dekantuese pas dekantimit te tyre nga lenda e ngurte ne pezulli, i bashkohen rrjetit te kanalizimeve. Meqenese masa e perdorur eshte mase e gurit gelqeror, keto ujera nuk permbajne elemente qe mund te ndotin ujerat. Ujerat industrial qe perdoren ne linjen e fraksionimit , orientohen me nje kanal siperfaqesor ne sistemin e vecante.

- **Ndikimi ne ujerat siperfaqesore**

Ne territorin ku zhvillohet aktiviteti i karrieres se gurit gelqeror, zona eshte e thate. Megjithate duhet thene se gjate shfrytezimit dhe transportit, rritet masa e materialit te ngurte qe do te shpelahet nga ujerat rrjedhes siperfaqesore,vecanerisht gjate renies se reshjeve.

- **Ndikimi ne ujerat nentokesore**

Ekzistenca e nje pako te madhe te gelqerorit ben qe te mos kemi ndotje te ujerave nentokesore nga zhvillimi i ketij aktiviteti. Megjithate duhet patur parasysh se mund te kete forma te karstit ne thellesi qe favorizojne grumbullimin e ujerave. Ndonese nuk ka ndikim ai duhet te merret parasysh gjate procesit te shfrytezimit. Kjo do te thote qe te respektohen kriteret e vena ne projektin e shfrytezimit.

- **Ndikimet nga zhurmat**

Zhurmat shkaktohen nga mjetet e ngarkim- shkarkimit, sitat vibruese dhe impianti i fraksionimit. Keto zhurma jane brenda normave te lejuara per mjedise pune 8 ore , megjithate shoqeria ka pajisur punetoret me mjete mbrojtese ndaj saj. Objekti eshte larg qendrave te banuara dhe punohet vetem ne nderresen e pare e ne keto rrethana intensiteti i zhurmave te krijuara prej linjes dhe mjeteve nuk perben problem shqetesues per zonen perreth. Gjate punimeve ne objekt, ne impiantin e fraksionimit te gurit gelqeror do te kete nivele zhurmash, te cilat do te vijne si pasoje e punimeve ne keto objekte. Nivelet e zhurmave mund te arrijne nivelin me te larte prej 75dB, por per kohezgjatje relativisht te shkurter.

- **Ndikimet ne flore dhe ne faune**

- **Fauna**

Ndikimet negative mbi faunen do te jene te ndryshme mbi klasat e ndryshme te saj. Po ti referohemi pasurise se zones ne faune del se klasa qe ka ndikimete rendesishme eshte ajo e zvarranikeve, por specie qe do te preken nuk figurojne nder ato te rrezikuarat, te mbrojtura, endemike apo kercenuese. Nuk ka ndikime mbi gjitaret e territorit, per shkak te mungeses se tyre. Nje ndikim jo te konsiderueshem do te kete gjate shfrytezimit te zones, ne shpendet qe pushojne apo gjuajne ne territor.

- **Flora**

Ndikime real do te bjere mbi dheun dhe zhavoret ne siperfaqe, dmth demtim i habitatit te flores dhe direkt mbi vegjetacionin duke e larguar plotesisht ate nga territori qe do te shfrytezohet.

- **Ndikimi ne mjedisin human**

Karriera dhe impianti I fraksionimit te gurit gelqeror ka ndikime edhe ne mjedisin human. Ndikimi I dretperdrejte perfshin hapjen, shfrytezimin dhe rehabilitimin e zones se shfrytezuar rreth saj, si dhe rrugen qe do te lidhe keto objekte me rrugen nacionale automobilistike. Ndikimi indirect perfshin aspekte te aktivitetit ekonomik, ku perdoren materialet e prodhuara nga zhvillimi I aktivitetit.

4. MASAT PER ELEMINIMIN / ZVOGELIMIN E NDIKIMEVE NEGATIVE NE MJEDIS

- ✚ **Territorri perreth impiantit**

I gjithë territori i subjektit dhe sheshet e levizjes jane te shtruara dhe te sistemuara. Nga shoqeria jane marre masa edhe per gjelberimin e territorit perreth impiantit duke bere te mundur mbjelljen me peme , gjithashtu nga stafi do tregohet kujdes per mbajtjen paster te ambientit dhe sperkatjen e tij here pas here me uje.

- ✚ **Menaxhimi I mjedisit**

Objektivi I planit te menaxhimit eshte te minimizoje apo eleminoje ndikimet negative ne mjedis te cilat mund te rezultojne nga zhvillimi I aktivitetit. Plani I menxhimit duhet te permbaje kategorite e meposhtme:

- Trajnim te punonjesve dhe masa te pergjithshme te mbrojtjes se mjedisit.
- Zbatim I udhezimeve per mbrojtjen dhe ruajtjen e bimesise dhe dherave siperfaqesore per te siguruar qe ky material te perdoret per mbulimin e zonave te zhveshura.
- Identifikimi I zonave te erozionit per shkak te punimeve te kryera dhe marrja e masave ndaj tyre
- Sigurimi qe mbetjet te trajtohen sipas planit te parashikuar.
- Sistemimi I materialeve ne vende te caktuara.
-

Masat zbutese per kontrollin e erozionit

- o Te minimizoje shqetesimet ne siperfaqe te tokes sa me shume te jete e mundur.
- o Do te respektohen te gjitha rregullat e parashikuara ne projekt.
- o Do te mbillen peme te reja.
- o Do te behet kanalizimi I ujerave ne menyre qe te mos ndikojne ne gerryerjen e formacionit.
- o Do te merren masa dhe per kanalizimet e ujerave te shiut.

Mbrojtja nga aksidentet dhe kushtet ne pune

➤ **Detyrat e firmes se ndertimit dhe e subjektit qe do te zhvilloje aktivitetin:**

- Do te punesohen punonjes qe e kane mbushur moshen per pune dhe specialist te profesioneve qe kerkohen.
- Do te punesohen punonjes qe kane eksperience te gjate ne profesion.
- Punonjesit para fillimit te punes dhe gjate saj ne menyre periodike do te instruktohen per rreziket ne pune dhe masat e menytrat per parandalimin e tyre.
- Punonjesit do te pajisjen me mjete mbrojtese si maska kunder pluhurave.
- Do te instruktohen punonjesit ne menyre periodike.

➤ **Detyrat e punonjesve:**

- Te mos perdore pije alkoolike para fillimit te punes dhe gjate kohes se punes.
- Te kontrolloje gjendjen teknike te pajisjeve ne perdorim para fillimit te punes dhe pasi konstaton gjendjen e rregullt te tyre fillon punen.
- Kur konstaton difekt dhe nuk eshte ne gjendje ta eleminoje ndalon punen dhe ve ne dijeni pergjegjesin me te afert.
- Te perdore mjetet individuale te mbrojtjes gjate punes.

Programi I rehabilitimit

Rehabilitimi I mjedisit do te kryhet si nevojë per te kthyer burimet e prekura ne gjendjen e meparshme sa te jete e mundur praktikisht. Mbi bazen e ndikimeve potenciale mjedisore te identifikuara do te veprohohet per ti zbutur ato. Per rehabilitimin e tokes duhet te shfrytezohen mbetjet e imeta nga materiali I nxjerre dhe do te plotesohen me shtrese rreth 20 cm dhe toke te pasur me pleh. Nese do te nevojitet stabiliteti I ketij dheu ne pjese te faqes se pjerrret, duhet te behet me trunqje te ngulura ne toke me thellesi relativisht te madhe (rreth 30-40cm).

Rehabilitimi I plote I mjedisoreve te territorit do te behet si me poshte:

- Mbjellja e periferive te territorit qe do te shfrytezohen nga impianti I fraksionimit.
- Mbjellja e sheshit te impiantit dhe karrieres me peme ne perfundim te shfrytezimit te tyre.

Programi i monitorimit te ndikimeve ne mjedis

Monitorimi i mjedisit ka per qellim qe nepermjet matjeve sistematike, vzhgimit, dhe raportimit ta paraqese ndryshimin e gjendjes se treguesve mjedisore qe te perberesve te mjedisit. Ne pergatitjen e programit te monitorimit specialistet do te marrin ne konsiderate mundesine per te realizuar nje monitorim realist te elementeve me ndikim ne mjedis.

Gjate zhvillimit te aktivitetit do te zbatohet nje plan momitorimi per mjedsin. Ky plan do te hartohet per te monitoruar hap pas hapi te gjitha ndikimet ne mjedis. Plani I monitorimit do te konsistoje:

5. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

KONKLUZIONE

- ✓ Impiant i fraksionimit te gurit gelqeror ne fshatin Floq te Qarkut Korce, synon perdorimin e ketyre materialeveper industrine vendase.
- ✓ Ne sheshin e impiantit te fraksionimit te gurit gelqeror do te behet ndarja e materialit ne fraksione te ndryshme dhe keto do te sistemohen ne shesh per tu derguar dhe perdorur ne subjekte te tjera ndertimore.
- ✓ Uji i perdorur ne procesin e thyerjes se gelqeroreve me ane te kanalizimeve do te dergohet ne vasken e dekantimit nga ku do te behet ndarja nga argjila dhe perseri uji i pastruar kthehet ne proces nga e para.

REKOMANDIME

- Te kontrollohet periodikisht dhe te pastrohet gropa dekantuese. Mbetjet e ngurta qe ndodhen ne masen rreth 5% te perdoren per mbushje te territorit dhe krijimit te mjedisit te pershtatshem per mbjelljen e metejshme te pemeve dhe luleve.
- Te merren masa dhe te kryhet rehabilitimi i mjedisit ne rastet e ndonje aksidenti.
- Te kryhet rregullisht kontrolli gjendjes teknike te agregateve dhe mjeteve te transportit.
- Te kontrollohen, pastrohen dhe mirembahen kanalet kulluse ne territor.
- Te njihen punonjesit periodikisht me rregullat e sigurimit teknik, si dhe me efektet pluhurave, zhurmave, vibrimet etj në jetën e tyre të përditëshme si dhe të merren masat e duhura për monitorimin në vazhdimësi të tyre me aparaturat dhe instrumentet e nevojshme.

Per “EKO - STUDIO - PROJEKT” sh.p.k

Ing. Xhevair DERMYSHI

MSc. Ing. Mjedisi Kenta Kryemadhi